



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P 318/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.05.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së BOE “Air” & “Truly Nolen” shpk, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-11178-02-28-2019 me objekt LOTI 1: “*Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekurat Shkodër, Lezhë*”, me fond limit të planifikuar për 2 vjet në vlerë 16,689,581 lekë (gjashtëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e një) lekë pa TVSh; Shumatorja e çmimeve njësi të shërbimeve të parashikuara për këtë lot është 53,801 (pesëdhjetë e tre mijë e tetëqind e një) lekë pa TVSh, zhvilluar në datën 25.03.2019, nga autoriteti kontraktor, Institutit i Shëndetit Publik.

Ankimues: “Air” & “Truly Nolen” shpk
Rruga Siri Kodra, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Institutit i Shëndetit Publik
Rruga “Aleksandër Moisiu” Nr. 80, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:**I**

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. OE ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së OE ankimues.

II**Rrethanat e çështjes**

II.1 Në datën 28.02.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-11178-02-28-2019 me objekt LOTI 1: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekturat Shkodër, Lezhë”, me fond limit të planifikuar për 2 vjet në vlerë 16,689,581 lekë (gjashtëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë

e nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e një) lekë pa TVSh; Shumatorja e çmimeve njësi të shërbimeve të parashikuara për këtë lot është 53,801 (pesëdhjetë e tre mijë e tetëqind e një) lekë pa TVSh, zhvilluar në datën 25.03.2019, nga autoriteti kontraktor, Institutit i Shëndetit Publik.

II.2. Në datën 25.03.2019 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 02.04.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Air	35,005	I skualifikuar
- Pastrime Silvio	13,441,380	I kualifikuar
- Alpen Pulito	12,860,448	I skualifikuar
- Akademia e Shëndetit Publik	16,333,600	I skualifikuar

II.4. Në datën 02.04.2019 BOE "Air" & "Truly Nolen" shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

-KVO-ja konstaton dhe vlerëson se ky ofertues nuk ka paraqitur të plotë dokumentacionin e kërkuar në Kriteret e Veçanta për Kualifikim, konkretisht si më poshtë vijon:

1. Formulari i ofertës është paraqitur sipas shtojcës 1, është përcaktuar % e pjesëmarrjes së shërbimit (66% dhe 34%, si më sipër) në kontratën e bashkëpunimit të përkohshëm me nr. 829 rep dhe nr. 148/1 kol., por BOE nuk ka përcaktuar elementët konkretë që do të kryejë secili nga anetarët e tij, kjo në kundërshtim me pikën 2, të nenit 74 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar;

2. Vërtetimi i paraqitur nga Shoqëria "AIR" sh.p.k., për përmbushjen e kriterit për xhiron mesatare vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit nuk përmbush vlerën sipas përqindjes që zotëron në marrëveshjen e bashkëpunimit;

3. Deklarata e paraqitur nga të dy Operatorët Ekonomikë të BOE, për përmbushjen e kriterit që duhet të kenë specialistë të trajnuar/certifikuar që do të kryejnë kalibrimin e paisjeve sipas kërkesave të teknikave dhe produkteve që do të përdoren, nuk përmban personin/at përgjegjës që do të kryejnë/në kalibrimin e paisjeve, siç është përcaktuar në Dokumentet Standarde të Tenderit;

II.5. Në datën 08.04.2019 BOE ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Bashkimi jonë i operatorëve ekonomikë për plotësimin e dokumentave të përgjithshëm dhe vecanta të tenderit ka dorëzuar në SPE Kontratën e Bashkëpunimit të Përkohshëm të Shoqërive Joint Venture JV noterizuar me nr.829 rep, nr.1488/1 kol dhe prokurën e*

përfaqësimit me nr.830 rep nr.149/2 kol. Kontrata e bashkëpunimit është në përputhje me LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik me nenin 74 të VKm nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. Kjo kontratë bashkëpunimi ka përcaktuar qartësisht në pikën 1 të saj se shoqëritë do të kryejnë të gjitha shërbimet e kërkuara sipas ndarjes në % të përcaktuar në pikën 3 të kësaj kontrate për secilin lot. Theksojmë se sipas formularit të ofretës të përgatitur nga vetë AK më konkretisht shtojca 1/1 shtojca 1/2 , shtojca 1/3 dhe shtojca 1/4 pjesë integrale e dokumentave të tenderit ky shërbim ka vetëm 1 zë atë të shërbimit të dezinfektimit , në tabelën e formularit të ofretës me pas janë përcaktuar teknikat që do të përdoren për të ofertuar cmimin për njësi për secilën nga to. Secila nga shoqëritë tonë ka kapacitetet dhe eksperiencën e nevojshme për aplikimin e të gjitha teknikave të përcaktuara në formularin e ofertave dhe për pasojë ndarja në % në këtë bashkim operatorësh është bërë për të gjithë vlerën e shërbimit të ofertuar për secilin lot. Kjo nënkupton se në përputhje me % e ndarjes së shërbimit sipas Join Venture cdo teknik aplikimi në secilën zonë do të kryhet bashkarisht sipas kësaj % ndarje. Njëkohësisht në marrëveshjen e bashkëpunimit midis OE është përcaktuar qartësisht se operatorët për realizimin e këtij shërbimi shërbimit të dizinfektimit për secilin lot bashkojnë të gjitha kapacitetet e tyre ligjore , kapitale teknike, pajisjet, automjetet, makinerive si dhe stafin teknik në një grup të vetëm gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës për realizimin me sukses të këtij shërbimi. Kjo marrëveshje bashkëpunimi nuk ka asnjë problem ligjor dhe është në përputhje me Ligjin dhe Rregullat e Prokurimit Publik. Oferta e paraqitur nga ana jonë për BOE është në përputhje me pikën 2 të nenit 44 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 Për prokurimin publik i ndryshuar. Kjo dispozitë urdhëruese për AK e urdhëron këtë të fundit që oferta e paraqitur nga ky BOE dhe kapacitetet teknike të tyre të konsiderohen nga AK si oferta dhe kapacitet e një kandidati të vetëm. Në këtë pikë kapacitetet e paraqitura dhe garantuara nga BOE janë në përputhje me kërkesat teknike e profesionale të kërkuara në DST për realizimin me sukses të kontratës. Për më tepër është përgjegjësi e AK që të vendosë kërkesa konkrete për të udhëzuar drejt ofertuesit në hartimin e ofertave. Në cdo rast AK duhet të përcaktojë dokumentat konkretë që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit. Pra në frymën e kësaj AK duhet të jetë konkret në kërkesa me qëllim që ti paraprij një procesi vlerësimi në përputhje me to.

- Lidhur me arsyen e dytë të skualifikimit sqarojmë se: shoqëria Air shpk ka paraqitur në SPE dokumentat e lëshuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë në mënyrë elektronike për vitet 2016,2017,2018 dhe vërtetim të lëshuar shkresërisht për xhiron e vitit 2019. Më konkretisht xhiro e shoqërisë Air është si më poshtë:

Viti 2016-4,327,342

Viti 2017-3,911,180

Viti 2018-4,934,050

Viti 2019-575,546

Po të mblidhen xhiro e vitit 2016,2017,2018 dhe të pjestohen me 3 del xhiro mesatare e tre viteve të fundit për shoqërinë Air e cila është 4,390,857 pa llogaritur këtu edhe xhiron e vitit 2019. Vlera e lotit I është 16,689,581. Pra xhiro që nevojitet për këtë lot është $16689581 * 40%$ e barabartë me 6,675,832 lek. BOE në rastin konkret e ka kapur dhe tejkualuar këtë xhiro të kërkuar me disa herë. Dhe specifikisht Air ka plotësuar pjesën e vet të xhiros në përputhje me % që ka marrë përsipër sipas marrëveshjes së bashkëpunimit. Kjo është lehtësisht e konstatueshme matematikisht.

- Lidhur me arysen e tretë të skualifikimit sqarojmë se: Në deklaratën e paraqitur për këtë qëllim nga shoqëria Air shpk dhe Truly Nolen degë e shoqërisë së huaj , shoqëritë tona në përpilimin e kësaj deklarate kanë thënë se deklarojnë se... dhe më pas kanë kopjuar Copy/Paste kërkesën sipas DT. Në mbështetje të kësaj deklarate ashtu sic kërkohet nga kriteri shoqëritë tona kanë paraqitur dhe dokumentat si më poshtë:
- Listpagesat për të dyja shoqëritë
- CV e punës për secilin punonjës
- Kontratat e Punës për secilin punonjës
- Certifikatat e lëshuara nga kompania që ka prodhuar pajisjen që do të kalibrohet për dhjetë punonjës të punësuar pranë shoqërive tona.

Pra ne si BOE jo vetëm kemi bërë deklartatën sic kërkohet në DT por dhe kemi paraqitur një listë të plotë të dokumentacionit që dëshmon se deklarata jonë është e vërtetë dhe se ne kemi dyfishin e kalibruesve që kërkohen për të gjitha lotet. Në kriterin e kualifikimit AK nuk ka përcaktuar se nga ofertuesit duhen listuar emrat e punonjësve në deklaratë. Për këtë AK nuk mund të ngrejë këto pretendime. Edhe një herë gjejmë se AK vlerëson ofertat jo në përputhje me kërkesat që ajo vetë ka vendosur në tender. Dokumentacioni i siprcituar si certifikata etj në mbështetje të deklaratës i vërteton AK-së, se BOE i zotëron kapacitetet teknike profesionale të kërkuara për realizimin me sukses të kontratës.

II.6. Me shkresën nr.76/32 prot datë 15.04.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje BOE ankimues duke vendosur mospranimin e ankesës.

II.7. Në datën 24.04.2019 BOE ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.76/43 prot datë 06.05.209 protokolluar me tonën me nr.749/2 prot datë 06.05.2019 dhe shkresës 76/42 prot datë 06.05.2019 protokolluar me tonën me nr .749/3 datë 06.05.2019 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “Air” & “Truly Nolen” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “*Vërtetimi i paraqitur nga Shoqëria ”AIR” sh.p.k., për përmbushjen e kriterit për xhiron mesatare vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit nuk përmbush vlerën sipas përqindjes që zotëron në marrëveshjen e bashkëpunimit*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Operatorët ekonomikë “Air” sh.p.k & “Truly Nolen” kanë krijuar bashkimin e përkohshëm të shoqërive me anë të kontratës së bashkëpunimit lidhur para një noteri publik Nr.829 Rep, Nr.148 Kol datë 24.03.2019. Nga shqyrtimi i kontratës së bashkëpunimit rezulton se bashkimi i përkohshëm i shoqërive është krijuar për realizimin e objektit “*Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane i ndarë në 4 lote.*”

Referuar kontratës së mësipërme të bashkëpunimit parashikohet se: *Për Lotin I Shoqëria Air do të marri përsipër realizimin e 66% të shërbimit ndërsa Truly Nolen degë e ëshoqërisë së huaj në këtë lot do të marri përsipër realizimin e 34% të shërbimit.*

III.1.2. Në Kreun VIII (“*Kushte të përgjithshme për zbatim*”), neni 74 (“*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*”), pika 1, dhe 3 të VKM 914/2014 parashikohet se :

“1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen nëbashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

III.1.3. Në shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 3.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Xhiroja mesatare vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit duhet të ketë një vlerë jo më e vogël se 40% të fondit limit të Lotit/Loteve që do të ofertojë. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron e realizuar gjatë tre viteve të fundit.

III.1.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se anëtari i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë “Air” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim nr.T00906008 datë 08.03.2019 “Për xhiron e tre viteve të fundit” nga ku rezulton se për periudhën tatimore:
 - 18-A xhiro vjetore është 4,934,050
 - 17-A xhiro vjetore është 3,911,180
 - 16-A xhiro vjetore është 4,327,342
- Vërtetim Nr.12588 prot datë 13.03.2019 “Për xhiron vjetore për vitin 2019 Janar-Shkurt “ - 572,546 lekë.

III.1.5. Në nenin 46, pika 1, gërma “c” të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përprjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”;c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilanci, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur.”

III.1.6. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 4, gërma “a” dhe “b”, përcaktohet se:

“Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse: dhe/ose*
- b) kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet”.*

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik, pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga antëri i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë ankimues Air shpk, gjykon se xhiro vjetore për tre vitet e fundit nuk plotëson vlerën prej 40 % të fondit limit të kontratës në përputhje me përqindjen e marrë përsipër në marrëveshjen e bashkëpunimit. Sikundër ka argumentuar Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlera mesatare e xhiros vjetore e tre viteve të fundit referuar vërtetimit të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë për subjektin Air shpk është 4,390,857 ndërkohë që vlera që duhet të përmbushet nga ky subjekt referuar përqindjes që ka marrë përsipër në marrëveshjen e bashkëpunimit është 4,406,049.38 lekë.

III.1.8. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se anëtari i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë "Air" sh.p.k. nuk plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor për kapacitetet ekonomike financiare lidhur me vlerën mesatare të xhiros vjetore për tre vitete e fundit.

Bazuar në nenin 1 dhe nenin 2 të LPP, në të cilët përcaktohet përkatësisht: "*Qëllimi i këtij ligji është: [...] të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*"; "*Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme: a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; b) transparencë në procedurat e prokurimit; c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve*", KPP gjykon se anëtari i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë "Air" shpk duhet të kishte paraqitur dokumentacionin në përputhje me dispozitat ligjore dhe kriteret kualifikuese.

Sa më sipër pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga BOE ankimues mbi skualifikimin e ofertës së tyre në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe BOE nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe gjendja e tyre faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij bashkimi operatorësh e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Air” & “Truly Nolen” shpk” shpk për procedurën e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-11178-02-28-2019 me objekt LOTI 1: “*Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekturat Shkodër, Lezhë*”, me fond limit të planifikuar për 2 vjet në vlerë 16,689,581 lekë (gjashtëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e një) lekë pa TVSh; Shumatorja e çmimeve njësi të shërbimeve të parashikuara për këtë lot është 53,801 (pesëdhjetë e tre mijë e tetëqind e një) lekë pa TVSh, zhvilluar në datën 25.03.2019, nga autoriteti kontraktor, Institutit i Shëndetit Publik.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 749 Protokolli; Datë 24.04.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha